



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale



THIRRJE PUBLIKE

- Për financimin e projekteve të personave juridik - OJQ-ve, në vlerë mbi 500.00€, nga fusha e Shëndetësisë dhe përkujdesjes Sociale:
02.05.2023

1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale u bënë thirrje të gjithë Personave juridik - OJQ-ve, të Regjistruara në Republikën e Kosovës të cilat veprojnë në Komunën e Vushtrrisë programi i punës i të cilave është i fokusuar në realizimin e aktiviteteve në fushën e Shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në këto fusha për Komunën e Vushtrrisë.

2. Personat juridik - OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

Shëndetësia:

- Programe/projekte për përkujdesje, trajtim të fëmijëve me nevoja të veqanta.
- Edukim shëndetësor të nxënësve dhe komunitetit.
- Programe për parandalimin e sëmundjeve.
- Programe për edukimin shëndetësorë të gruas.

Përkujdesje sociale:

- Projekte nga fusha e përkujdesjes sociale.
- Projekte për pronovimin, mbrojtjen e vlerave të luftës, mbështetjen e viktimave të luftës.
- Projekte për ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe sociale për komunitetin.
- Projekte nga fusha e barazisë gjinore dhe sociale.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 27.000,00euro.

4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 500,00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 15.000,00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 23.05.2023.

6. Personat juridik - OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti dy (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje publike. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit kalendarik 2023.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë Personat juridik - OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Vushtrrisë.

Personat juridik - OJQ-të duhet të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale.

Para nënshkrimit të kontratës, Personat juridik - OJQ duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe prova se Personat juridik - OJQ-të ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare www.kk.rks-gov.net/vushtrri/.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht në zarf të mbyllura, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Vushtrrisë

Rruga "Isa Boletini" Nr.10

(zyra e pranimit)

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: naim.ferizi@rks-gov.net.



Drejtori i DSHPS

Nexhmedin Rashica
Nexhmedin Rashica